



# Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën

**Parimi: Identiteti i viktimave dhe të mbijetuarve/ave dhe familjarëve të tyre  
duhet të mbrohet**

**Studim i rastit**



## Parimet për ballafaqimin me të kaluarën

Parimet për ballafaqimin me të kaluarën është një iniciativë qytetare, e promovuar nga koalicioni jo formal i përbërë nga 5 organizata dhe një eksperte: Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë, Qendra Kosovare për Rehabilitimin të Mbijetuarve të Torturës, Integra, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, BIRN dhe Nora Ahmetaj. Grupi ka ndërmarrë një iniciativë të përbashkët për të hartuar dhe aprovuar një grup parimesh të cilat do të informojnë dhe udhëzojnë akterët politik dhe publik se si do të trajtojnë viktimat, të mbijetuarit/at, të kaluarën e dhimbshme dhe narrativat historike. Iniciativa ka për qëllim që të parandalojë diskursin dhe veprimet e dëmshme në lidhje me trashëgiminë e konfliktit dhe do të shërbejë si dokument referues, ku secili/a që shkel parimet e tij/saj duhet të mbahet moralisht përgjegjës. Andaj, qëllimi është që të aplikohen këto parime dhe të respektohen vlerat dhe ndjenjat që ato mishërojnë, në mënyrë që të sigurohet që viktimat dhe të mbijetuarit të mos dëmtohen dhe se veprimet që ndërlihen me ballafaqimin e të kaluarës do të kontribuojnë në procesin e pajtimit<sup>1</sup>. Tani kur parimet janë zhvilluar e janë organizuar, gjithashtu edhe janë të shpjeguara mirë, ka një rëndësi kryesore që të prezantohen tek një publik i gjerë dhe të promovohen në mënyrë korrekte. Ne besojmë se një nga mënyrat për të bërë njerëzit të kuptojnë për rëndësinë e parimeve është të tregohet për dëmet, pasojat dhe dhimbjen, të cilat mund të shkaktohen në situatat kur parimet janë të shkelura. Prandaj koalicioni do të publikojë disa analiza të cilat do të përpilohen nga ana e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) dhe ne do të përpiqemi që të sjellim shembuj konkret nga e kaluara ku parimet janë përdorur në mënyrë të duhur apo edhe janë keqpërdorur. Një nga këto parime është “Identiteti i viktimave dhe të mbijetuarve/ave dhe familjarëve të tyre duhet të mbrohet”.

### Identiteti i viktimave dhe të mbijetuarve/ave dhe familjarëve të tyre duhet të mbrohet

Duhet siguruar që viktimat dhe të mbijetuarit/at mbrohen në mënyrë efektive nga stigma, frikësimi dhe presionet që mund të pësojnë. Nuk duhet të ketë zbulim publik të identitetit të viktimave dhe të mbijetuarve/ave, as familjarëve të tyre, përveç nëse ata/ato japin pëlqimin e tyre. Privatësia e tyre duhet të mbrohet plotësisht dhe të respektohet në çdo mënyrë.

### Hyrje

Si pasojë e luftës së fundit në Kosovë, sipas të dhënave preleminare të Fondit për të Drejtën Humanitare (FDH) dhe Fondit për të Drejtën Humanitare në Kosovë (FDHK), në total janë 13535 persona të vrarë/të zhdukur në periudhën gjatë viteve 1998-2000<sup>2</sup>. Viktimat dhe të mbijetuarit e luftës në Kosovë duhet të trajtohen me respekt dhe dinjitet nga mbarë shoqëria, por specifikisht “nga policia, prokurorët, gjyqtarët ose edhe organet e tjera të zbatimit të ligjit<sup>3</sup>” dhe të mënjanohen mundësitë stigmatizimit të tyre dhe pasojat që ai i shkakton.

Ata/ato mund ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre ligjore që të raportojnë krimin para organeve të ndjekjes dhe të marrin pjesë në procedura penale. Sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK) “I dëmtuari ka cilësinë e palës në procedurë penale<sup>4</sup>”. I dëmtuari apo viktimat, është “personi të cilit çfarëdo e drejte personale ose pasurore i është shkelur ose i është rrezikuar me veprën penale<sup>5</sup>”. Personi i dëmtuar është ai të cilit i shkaktohet “dëmi që drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë rezulton nga një veprim kriminal, duke përfshirë humbjen e pronës, humbjen e fitimit, heqjen e lirisë, dëmtimin fizik, dëmtimin psikik apo humbjen e jetës së bashkëshortit ose anëtarit të familjes së afërme<sup>6</sup>”. “I dëmtuari ka të drejtë në kompensimin e arsyeshëm të urdhëruar nga gjykata prej të pandehurit ose të pandehurve që kanë pranuar ose janë shpallur fajtor për dëmin

<sup>1</sup> Principi ALB (vibr-ks.org)

<sup>2</sup> Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, Libër Kujtimi I Kosovës, <https://www.hlc-kosovo.org/sq/aktivitetet-tona>

<sup>3</sup> Kodi I Procedurës Penale I Republikës së Kosovës, Kapitulli VI, Neni 62, Pika 1.1, Faqe 24, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> Kodi I Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Neni 19, Pika 1.9, Faqe 6, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

<sup>6</sup> Kodi I Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Neni 19, Pika 1.14, Përkufizimet, Faqe 6, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>



material, fizik dhe emocional të shkaktuar nga kryerja e veprës penale për të cilën i pandehuri ose të pandehurit janë shpallur fajtor<sup>7</sup>”.

Mbrojtja e identitetit të viktimave dhe të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë mund të zbatohet në rast të paraqitjes së kërkesës së tyre me shkrim për mbrojtje të identitetit, si dhe me kërkesën e prokurorisë së shtetit për të mbrojtur identitetin e viktimave, të mbijetuarve dhe familjarëve të tyre nga rreziqet të cilat mund të i shkaktohen në rast të zbulimit të identitetit të tyre. Këto kërkesa mund të paraqiten në cilëndo fazë të procedurës penale, nga cilado nga palët në procedurë, e poashtu edhe identiteti i familjarëve të viktimave mund të mbrohet, meqë me zbulimin e identitetit të tyre mund të zbulohet edhe identiteti i personit i cili me ligj gëzon mbrojtjen e identitetit.

Në bazë të nenit 221 paragrafit 3, të KPPRK, “pas marrjes së kërkesës, gjyqtari kompetent mund të urdhëroj masa të përshtatshme mbrojtëse për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin...”. Urdhri për masa mbrojtëse si dhe urdhri për anonimitet bëhet në rast kur ekziston rreziku serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues, dëshmitarin apo anëtarët e familjeve të tyre. Rrezik serioz nënkupton “frikë e justifikueshme për rrezikim të jetës, shëndetit fizik apo mendor, pronës së të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues, dëshmitarit ose anëtarit të familjes së të dëmtuarit apo të dëshmitarit, si pasojë që pritet për faktin se i dëmtuari, dëshmitari bashkëpunues ose dëshmitari ka dhënë prova gjatë marrjes në pyetje apo dëshmimit në gjykatë<sup>8</sup>”.

Në këtë kontekst, në një intervistë për FDHK, Drita Hajdari, prokurore speciale dhe udhëheqëse e Departamentit për krime lufte në kuadër të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) ka shpjeguar hapat ligjore të cilat ndiqen nga prokuroria gjatë procedimit të rasteve të dhunimit seksual gjatë luftës në Kosovë, si dhe ka dhënë disa rekomandime në lidhje me mënyrën se si do të mund të mbrohej identiteti i viktimave gjatë zhvillimit të procedurës penale.

Prokurorja ka theksuar që, pavarësisht nga statusi juridik i ndryshëm në mes të viktimës dhe dëshmitarit, në praktikë ndodhin raste kur viktimat e krimit paraqitet edhe në cilësinë e dëshmitarit. Madje në disa raste edhe si dëshmitarë i vetëm i rastit, siç është dhunimi gjatë luftës.

Në këto raste gjatë intervistimit të parë në prokurori, viktimat njoftohet për të drejtat e tij/saj të përcaktuara sipas KPPRK. E pastaj njoftohet se do të merret në pyetje edhe si dëshmitarë i rastit dhe njoftohet për të drejtat dhe detyrimet ligjore si dëshmitarë, siç është detyrimi i dëshmitarit për të dëshmuar dhe për të treguar të vërtetën. Por përpos këtyre detyrimeve, dëshmitari gjithashtu njoftohet për të drejtën për të heshtur, në rast se me deklaratën e vet ai mund ta dëmtoj veten. Në këto raste kemi të bëjmë me paraqitjen e një personi në cilësinë e viktimës dhe njëherit në cilësinë e dëshmitarit, sepse këtë e imponon vet rasti. Viktimat duhet të dëshmojnë për krimin që e ka përjetuar, e shpeshherë në rastet siç është dhuna seksuale gjatë luftës, nuk ka dëshmitarë okularë. Në shumicën e rasteve të tilla, kemi dëshmitarë indirekt të cilët mund të dëshmojnë se viktimat është marrë nga forcat ushtarake apo policore, por që nuk kanë parë direkt se çka ka ndodhur me viktimën, apo dëshmitarë indirekt të cilët dëshmojnë për gjendjen e viktimës pas kryerjes së krimit ndaj saj, e që mund të janë familjarët e saj, mjekët apo dëshmitarët sipas të dëgjuarit. Prandaj në këto raste shpesh para prokurorisë paraqitet i njëjti person edhe në cilësinë e viktimës, por edhe si dëshmitari i vetëm i rastit.

Sipas prokurores Drita Hajdari, ekziston një bazë solide ligjore për mbrojtjen e viktimave të dhunës seksuale. Meqenëse viktimat e dhunës seksuale e kanë përjetuar një krim që lë pasojat të rënda për jetën dhe shëndetin e tyre si dhe për t'i mbrojtur ato nga stigma dhe paragjykimet, jo vetëm viktimës por edhe familjarëve të tyre, prokuroria kërkon nga gjykata nxjerrjen e urdhrit për masa mbrojtëse, duke përdorur metodat si p.sh. caktimin e pseudonimit, lënien bosh ose shlyerjen e emrave, adresave, vendit të punës, profesionit ose ndonjë të dhënë apo informatë tjetër që mund të përdoret për të identifikuar të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues apo dëshmitarin, vendimi për seancën e mbyllur për publikun, etj.

<sup>7</sup> Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Neni 62, Paragrafi 1, Pika 1.4, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

<sup>8</sup> Kodi i procedurës penale të Republikës së Kosovës, Kapitulli XIII Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve. Neni 220, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>



Ka pasur raste kur viktimat kanë vendosur të dëshmojnë por pasi kanë arritur në prokurori e kanë ndjerë veten jo të gatshme që të ballafaqohen sërish me këto trauma, e rrjedhimisht kanë refuzuar të deklarohen. Arsyeja se pse ndodh një gjë e tillë u shpjegua nga prokurorja speciale Hajdari, ku ajo tha se sa herë që mirret në pyetje viktimat, ajo ritraumatizohet dhe riviktimizohet.

Prokurorja gjithashtu përmendi se si pengesë në dëshmimin e viktimave për rastet e dhunimit seksual gjatë luftës paraqitet kalimi i kohës dhe ndryshimi i rrethanave në jetërat e viktimave. Në praktikë ka ndodhur që viktimat të refuzojë të jap dëshminë për shkak të ikjes nga riviktimizimi dhe ritraumatizimi. Kjo ka ndodhur pasi që kanë ndryshuar rrethanat e jetës pas ngjarjes apo krimit i cili i ka ndodhur, e që në shumë raste viktimat paraqitet të ketë krijuar familje të re, pra të jetë e martuar dhe të ketë fëmijë, por që familjarët e saj nuk kanë dijeni për rastin. Prandaj përfshirja e saj në procedurë penale mund të shpie te zbulimi i ngjarjes që ajo e ka fshehur dhe që mund të ketë pasoja për jetën e saj. Në këto raste viktimat në këtë mënyrë e mbrojnë veten dhe familjarët e tyre, duke mos dëshmuar për rastin para prokurorisë.

Në rrethana të tilla prokuroria zyrtarisht e mbyll rastin dhe ia lë në dispozicion të viktimës që kurdo të ndihet e gatshme të dëshmojë, prokuroria mund t'a rihap rastin. Në këtë rast të drejtat dhe detyrimet që i atribuohen viktimës, kanë epërsi mbi të drejtat dhe detyrimet që i ka i njëjti person në cilësinë e dëshmitarit. Që do të thotë se detyrimi i tij për të dëshmuar (detyrim ky i dëshmitarit në procedurë penale), hidhet poshtë në momentin kur i njëjti person në rolin e viktimës refuzon të dëshmojë, për arsyt e cekura më lartë.

Prokurorja Hajdari dha edhe disa rekomandime, e që sipas saj të gjithë pjesëmarrësit në procedurë penale duhet të respektojnë rregullat për mbrojtjen e identitetit të viktimës dhe gjithashtu të sigurohen mekanizmat e duhur për të mbrojtur identitetin e viktimës me mbërritjen e saj/tij në prokurori, polici dhe gjykatë. Sipas prokurores do të duhej që të organizohen aktivitete adekuate për vetëdijësimin publik, për të mbrojtur viktimat nga stigma dhe pasojat e tjera të mundshme. Në këtë mënyrë, viktimat do të inkurajohen të denoncojnë krimin tek organet e ndjekjes dhe të realizojnë të drejtat e tyre ligjore, e që përfundimisht do të mundësonte që kryesit të vihen para drejtësisë, pa asnjë pasojë për viktimat.

Në Kosovë akoma nuk ekziston numri i saktë i viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, pasi që një numër i konsideruar është numër i errët që nuk do të zbulohet kurrë, për shkak se viktimat kanë vendosur të mos flasin dhe të qëndrojnë të heshtura. Deri më tani në prokurori janë paraqitur 50 raste të dhunimeve seksuale gjatë luftës në Kosovë<sup>9</sup>.

Përpos mbrojtjes së identitetit të viktimave, të mbijetuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre para gjykatave dhe gjatë procedurave të caktuara penale, është esenciale që të mbrohet identiteti i tyre edhe jashtë institucioneve të drejtësisë, përpos rasteve të cilat ata japin pëlqimin e tyre dhe dëshirën për t'u paraqitur publikisht.

Stigmatizimi i viktimave, me theks të veçantë të atyre të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, paraqitet si barrierë kryesore e cila i shtyn këto viktimat që të fshihen, si dhe të fshehin të vërtetën e tyre. Gjithashtu mbrojtja e familjarëve të viktimave nga presionet e shoqërisë si dhe nga presionet mediatike, paraqitet si një ndër shkaqet e cila i ndalon viktimat për të ndërmarrë hapat e nevojshëm për rrëfimin e historive të tyre të tmerrit dhe përfitimin e benefiteve ligjore për vuajtjet të cilat i janë shkaktuar atyre.

Për këtë dëshmon edhe një nga viktimat direkte të dhunimit seksual gjatë luftës në Kosovë. Identiteti i saj u mbajt i fshehur nga ana e një mediumi i cili e kishte publikuar historinë e saj, në të cilin viktimat tregonte arsyen se pse ajo nuk kishte aplikuar për statusin e viktimës së dhunës seksuale të luftës. Ajo tha se “Familja ime nuk dëshiron të më figurojë emri askund. Tash janë familje e madhe. Kanë martuar djemtë e vajzat dhe kanë bërë shumë lidhje familjare. Nuk duan që dikush ta përmend këtë<sup>10</sup>”.

Me këtë pohim viktimat në fjalë tregoi se ajo për hir të mbrojtjes së anëtarëve të saj të familjes, heziton që të marrë atë çka edhe ligjërisht i takon asaj si viktimë e dhunës seksuale.

<sup>9</sup> Intervistë me Prokuroren Speciale dhe Udhëheqësen e Departamentit për Krime Luftë në kuadër të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Drita Hajdari.

<sup>10</sup> Balkan Transitional Justice, Agonia e Pafund e Grave të Mbijetuarve të Dhunës së Luftës në Kosovë, 29.05.2017, <https://balkaninsight.com/2017/05/29/agonia-e-pafund-e-grave-t%C3%AB-mbijetuar-t%C3%AB-dhun%C3%ABs-s%C3%AB-luft%C3%ABs-n%C3%AB-kosov%C3%AB-05-28-2017/?lang=sq>



Gjithashtu edhe libri “Unë jam Anemone”, libër ky i cili i shpërfaq kronikat e fuqishme të përdhunimit, nga bashkëautorja Mirlinda Sada (përfaqësuese e Medica Gjakova), u argumentua se disa viktimat kishin heziturar që të aplikojnë për procesin e verifikimit, duke pasur frikë nga izolimi i mundshëm nëse identifikoheshin publikisht<sup>11</sup>. Edhe Veprorë Shehu nga Medica Kosova kishte deklaruar se ka shumë viktimat të dhunës seksuale të cilat kanë heziturar që të aplikojnë për të përfutur njohje të statusit të tyre, si rezultat i frikës nga stigma dhe izolimi<sup>12</sup>.

“Prandaj nuk është e mjaftueshme që të punohet vetëm me të mbijetuar të dhunës seksuale, pasi që ajo paraqitet të jetë plagë e shoqërisë në përgjithësi aq sa është plagë e një individi. Shoqëria duhet të ketë qasje më të mirë ndaj tyre, të kuptojë dhimbjet, të ndihet përgjegjëse, të solidarizojë dhe të mos i stigmatizojë ato<sup>13</sup>”.

Është shumë e rëndësishme që kushdo që ka mandat për të punuar me këto kategori të viktimave, të ketë kujdes të shtuar sa i përket publikimit të identitetit të tyre. Kërkesa e tyre për publikimin apo jo të identitetit të tyre apo në ndonjë formë të familjarëve të tyre, duhet të respektohet maksimalisht, në mënyrë që të mos i nënshtrohen stigmatizimit të mundshëm dhe formave të tjera të presioneve të cilat do të mund shkaktojnë pasoja të rënda për jetën dhe shëndetin e atyre.

---

Në një nga publikimet e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), me titull *E drejta për të vërtetën “Viktimat pa emër”*, janë paraqitur disa nga arsyet se pse viktimat nuk i kanë paraqitur rastet e tyre në organet e ndjekjes. Nga hulumtimet e kryera nga QKRMT thuhet se rreth 232 viktimat janë deklaruar se nuk i kanë paraqitur rastet e tyre në organet e ndjekjes për shkak se “kishin pasur frikë nga paragjykimi, që përfshijnë zbulimin e të dhënave personale, stigmatizimin nga rrethi i ngushtë dhe i gjerë, përballja në gjykatë dhe zbulimi i identitetit<sup>14</sup>”.

Përpos këtij publikimi të QKRMT-së, më 23 shtator të vitit 2020, po kjo organizatë kishte prezentuar Protokollin për identifikimin, hetimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë<sup>15</sup>. Dokumenti jep mundësinë që të përdoret për të trajtuar, mbështetur dhe përfaqësuar të drejtat e të mbijetuarve dhe të dëshmitarëve të dhunës seksuale në luftë. Mbi të gjitha në këtë dokument ofrohen rekomandime rreth përdorimit të masave mbrojtëse të viktimave dhe të mbijetuarve/ave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Udhëzohen të gjithë profesionistët që mirren me këtë fushë që të sigurohen se po respektohet pëlqimi i bazuar i viktimës dhe në këtë mënyrë profesionistët “të krijojnë situata të besimit të vërtetë që do t’i mundësojnë viktimës/dëshmitarit të dakordohet lirshëm dhe vullnetarisht ose të ndjehet mjaft rehat sa të refuzojë të deklarohet”. Poashtu viktimës duhet t’i jepet mundësia që “të vendosë nëse do të flasë apo jo, në çfarëdo kohe gjatë procesit” dhe ti ofrohet “kohë e mjaftueshme për të marrë vendim, duke pasur parasysh pasojat domethënëse dhe komplekse të pjesëmarrjes së viktimës dhe familjeve të tyre<sup>16</sup>”.

E në anën tjetër “Protokollin ndërkombëtar për dokumentimin dhe hetimin e dhunës seksuale në konflikt” e specifikon parimin e “pëlqimit të bazuar”, parim ky i cili paraqitet si domosdoshmëri gjatë mbledhjes së informatave lidhur me dhunën seksuale. “Të gjithë të mbijetuarit dhe dëshmitarët duhet të japin pëlqimin e tyre të bazuar që të intervistohen dhe të pyeten, të fotografohen, t’u regjistrohen informatat, të referohen tek ndonjë shërbim mbështetës dhe që informatat dhe të dhënat e tyre t’u përdoren bashkë me palët e treta<sup>17</sup>”.

---

<sup>11</sup> Balkan Insight, 02.12.2019, <https://balkaninsight.com/2019/12/02/libri-i-dhimbjeve-te-mbijetuarat-e-perdhunimeve-te-luftes-ne-kosove-tregojne-historite-e-tyre/?lang=sq>

<sup>12</sup> Balkan Insight, 12.06.2018, <https://balkaninsight.com/2018/06/12/procesi-i-regjistrimit-t%C3%AB-viktimave-t%C3%AB-p%C3%ABrdhunimeve-t%C3%AB-luft%C3%ABs-i-l%C3%ABkundur-06-11-2018/?lang=sq>

<sup>13</sup> I am Anemone, Medica Gjakova, Faqe 10

<sup>14</sup> QKRMT, E drejta për të vërtetën “Viktimat pa emër”, 10.3. Arsyet pse nuk është paraqitur rasti në institucionet e drejtësisë. Faqe 72, <https://drive.google.com/file/d/1st18cwFgQNe0-eCxpP574q6ENLZvCPax/view>

<sup>15</sup> Anadolu Agency, 23.09.2020, Kosovë, prezantohet Protokollin për mbrojtjen e identitetit të viktimave të dhunës seksuale në luftë, <https://www.aa.com.tr/sq/balkani/kosov%C3%AB-prezantohet-protokollin-p%C3%ABr-mbrojtjen-e-identitetit-t%C3%AB-viktimave-t%C3%AB-dhun%C3%ABs-seksuale-n%C3%AB-luft%C3%AB/1983029>

<sup>16</sup> Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, Protokollin për identifikimin, hetimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë

<sup>17</sup> Protokollin ndërkombëtar për dokumentimin dhe hetimin e dhunës seksuale në konflikt, Zyra e Jashtme e Britanisë së Madhe dhe Komonuelthit dhe kontributi i



Sipas këtyre publikimeve kuptojmë që viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës kanë të drejtën që të japin pëlqimin e tyre ose jo, krejtësisht në mënyrë vullnetare, në lidhje me dhënien e dëshmimeve të tyre mbi rastet të cilat u kanë ndodhur. Të gjitha institucionet apo edhe profesionistët të cilët kanë për detyrë që të identifikojnë dhe të dokumentojnë këto lloje të krimeve të kryera, duhet gjithsesi që t'a respektojnë vullnetin e lirë të viktimave në raport me deklaratimet e tyre.

Serbeze Haxhiaj, gazetare hulumtuese nga Balkan Investigative Reporting Network (BIRN) dhe RTK, në një përgjigje të dhënë për FDHK në lidhje me çështjen e mbrojtjes së identitetit të viktimave të dhunës seksuale, ka thënë se “Hezitimi për të biseduar me media, për hulumtime akademike apo natyrave tjera, për shkak të frikës së zbulimit të identitetit, është ende një gjë krejt e zakonshme”. Sipas Haxhiaj thuhet se viktimat e dhunës seksuale tanimë paraqiten të jenë në të pesëdhjetat apo edhe më shumë dhe se sa më shumë që kalon koha, frika nga stigma rrënjësohet edhe më shumë. Ato nuk duan të zbulohen jo vetëm për shkak të rrethit, bashkëshortëve, por shpesh edhe për shkak të fëmijëve. Në shumë raste fëmijët nuk pranojnë faktin e dhunimit ose nuk duan që nënat apo baballarët e tyre të flasin. Shumë nga ato kanë jetuar momentet më traumatike që kanë qenë vendimtare për jetën e tyre duke mbajtur brenda të vërtetën e dhunimit dhe tani nuk duan që më të flasin. Viktimat tjera që kanë folur hapur u kanë dhënë një kurajo për të ecur përpara por nuk ka pasur shumë motivim për të folur në publik.

Haxhiaj poashtu ka ndarë edhe një rast në të cilin viktimat e cila kishte mbytur fëmijën e saj, i lindur si pasojë e dhunimit dhe ishte burgosur në atë kohë. Në vitin 2000 nuk kishte pranuar që të flasë për BIRN, por e kishte konfirmuar se çfarë kishte ndodhur, duke u drejtuar se “e kupton kur je e shkatërruar dhe asgjë më nuk do të jetë normale” dhe se kishte pohuar se mund të vrasë veten, nëse zbulohet emri i saj.

Kjo është një dëshmi tjetër në lidhje me rëndësinë që e paraqet fakti se identiteti dhe vullneti i viktimave të dhunës seksuale, duhet të mbrohet me çdo kusht.

## Rekomandime

Në rend të parë rekomandojmë që “Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën<sup>18</sup>”, të respektohen dhe adaptohen nga të gjithë akterët politik dhe publik, e të cilët merren me trajtimin e së kaluarës.

Sipas ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre, thuhet se afati përfundimtar për parashtrimin e kërkesave për realizimin e të drejtave të tyre është 5 vite nga fillimi dhe zyrtarizimi i punës së Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e personave të dhunuar gjatë luftës<sup>19</sup>. Andaj rekomandojmë që edhe ky afat të zgjatet edhe më tej, në mënyrë që t'u ipet kohë shtesë viktimave për parashtrimin e kërkesave të tyre.

Rekomandojmë mediave që të mos publikojnë identitetin e individëve që i takojnë cilësdo kategori të viktimave, pa pëlqimin e bazuar.

*Ky projekt implementohet me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane në Kosovë dhe Ambasadës Britanike në Prishtinë përmes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, dhe përmbajtja e përfshirë në këtë analizë nuk pasqyron pikëpamjet e tyre.*

individëve dhe organizatave të tjera, 6.1. Pëlqimi I bazuar, Faqe 45,

[https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/532510/PSVI\\_Protocol - Albanian.pdf](https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/532510/PSVI_Protocol_-_Albanian.pdf)

<sup>18</sup> Principi ALB (vihar-ks.org)

<sup>19</sup> Komisioni zyrtarisht ka caktuar datën 5 Shkurt 2018 për fillimin e procesit të aplikimit për përfitim të statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.

 [@dwpkosovo](#)

 [@dwpkosovo](#)

 [@dwpkosovo](#)

 [dwpkosovo](#)